



	Universiteti "UKSHIN HOTI"
University of Prizren	
Univerzitet Prizrena	
<b>"UKSHIN HOTI"</b>	
Pranuar me dt. <b>21.09.2016</b>	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
<b>901</b>	<b>01 - 276</b>

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET

### UNIVERSITETIT TË GJAKOVËS "FEHMI AGANI" DHE UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN

Pranuar	<b>22. 09 2016</b>	viti	
Nj. org.	Numër	Sasia	Vlera
<b>01</b>	<b>901</b>	<b>1</b>	

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit "Ukshin Hoti" Në Prizren, në vijim UPz, adresë "Ruga e shkronjave" Nr. 1, 20000 Prizren, përfaqësuar nga Rektori - Prof. Dr. Ramë Vataj

dhe

Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë, Rr. "Ismail Qemali" .p.n. Gjakovë, përfaqësuar nga Rektori - **Prof. Dr. Shaban Buza**

Palët e mësipërme bien dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja"), është zhvillimi i bashkëpunimit akademik në nivelin e studimeve universitare, si dhe zhvillimi i aktiviteteve kërkimore, shkencore dhe kulturore ndërmjet dy Universiteteve.

#### Neni 2

Bashkëpunimi do të mbështetet mbi bazën e parimeve demokratike dhe në pajtim me autonominë dhe lirinë akademike të të dyja palëve. Palët zotohen që të marrin në shqyrtim nevojat e përbashkëta gjatë bashkëpunimit të tyre më qëllim për të përfituar nga zhvillimi dhe shkëmbimi shkencor, edukativ dhe kulturor.

#### Neni 3

Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në protokolle të veçanta të cilat do të firmosen pasi njësitë brenda universiteteve të kenë përcaktuar detajet e marrëveshjeve në praktikë, dhe më pas do të firmosen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë.

Protokolli do të përcaktojë subjektet dhe pjesëmarrësit e bashkëpunimit, kuotat e shkëmbimit dhe detajet e tjera të rëndësishme. Protokolli do jetë pjesë integrale e kësaj Marrëveshje.

#### Neni 4

Palët mundën të zhvillojnë aktivitetet e mëposhtme në fushat akademike me interes të përbashkët:

- a) Shkëmbim stafi akademik dhe sipas nevojave të UGJk-së, stafi i rregullt akademik i UPz-së do të angazhohet në UGJk dhe anasjelltas në bazë të kësaj marrëveshje duke mos iu nënshtruar procedurave të konkursit publik;
- b) Shkëmbim studentësh të ciklevë të ndryshme studimi për periudha semestrale studimi ose për periudha të praktikave;
- c) Aktivitete dhe publikime të përbashkëta në kërkim shkencor;
- d) Pjesëmarrje në seminare, konferenca, evenimente dhe takime akademike;
- e) Shkëmbim të materialeve akademike si dhe informacione të tjera të nevojshme;
- f) Programe të veçanta akademike afatshkurtra.

#### Neni 5

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e firmosjes nga përfaqësuesit e secilit Universitet.

Marrëveshja do të jetë në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, që nga data e nënshkrimit nga të dyja palët, me mirëkuptimin që mund të përfundojë edhe përpara këtij afati, me iniciativën e njërsë prej palëve, duke njofuar me shkrim 12 (dymbëdhjetë) muaj më parë.

#### Neni 6

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet dhe/ose të amendohet në pjesë të veçanta të saj, nëse të dy palët bien dakord me shkrim. Ndryshimet dhe/ose amendimet do të bëhen në formën e anekseve të Marrëveshjes dhe do të firmosen nga personat e autorizuar të të dyja palëve.

#### Neni 7

Të dyja Universitetet i përbahen politikave të mundësive të barabarta dhe nuk diskriminojnë mbi baza racore, të ngjyrës, moshës, etnive, fetare, paaftësive, originës kombëtare apo orientimeve seksuale. UP dhe UHZ do të udhëhiqen nga këto parime në administrimin e kësaj marrëveshje.

#### Neni 8

Marrëveshja aktuale është nënshkruar në 4 kopje identike në gjuhën Shqipe, dy nga të cilat janë të UPZ dhe dy të tjera të UGJk.

Të gjitha kopjet kanë të njëjtën fuqi ligjore dhe janë njësoj të vlefshme për të dyja palët.

Për Universitetin “Ukshin Hoti”

Prof. Dr. Ramë Vataj, Rektor



Për Universitetin “Fehmi Agani”

Prof. Dr. Shaban Buza, Rektor

